VENDIM
Nr.58, datë 8.9.2010

PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE TË LICENCIMIT TË SHOQËRISË "RUDNAP ENERGY TIRANA" SHPK, NË AKTIVITETIN E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 8 pika 2 germa "a", 9 dhe 13 pikat 1, germa "d" të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, nenit 4 pika 1, germa "g", nenit 10 pikat 1 dhe 3 të "Rregullores për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave", të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.108 datë 9.9.2008, dhe nenit 18, pikat 1, germa "a", dhe 3 të "Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve, nr.21, datë 18.3.2009, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 8.9.2010, pasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë "Rudnap Energy Tirana" sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit mbi licencimin në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike,

dhe konstatoi se:

Aplikimi plotëson përgjithësisht kërkesat e ERE-s, lidhur me licencimet në sektorin e energjisë elektrike të:

- formatit të aplikimit (neni 9, pika 1);
- dokumentacionit juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2);
- dokumentacionit financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3);
- dokumentacionit teknik (neni 9, pika 4.10).

Mungesa e dokumentacionit që ka të bëjë me bilancin e tri viteve të fundit të shoqërisë është në pritje për t'u plotësuar (neni 9 pika 3, germa "c").

Për gjithë sa më sipërcituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurave për shqyrtimin e aplikimit për licencë të shoqërisë "Rudnap Energy Tirana" sh.p.k., në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike.
2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-s
Bujar Nepravishta